

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 22 dhe neni 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18) ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën zgjedhore mësimore **Arti dramatik për vitin IV (e katërt) të arsimit të mesëm - gjimnaz** për vitin shkollor 2020/2021.

1. HYRJE

Programi mësimor i shkurtuar, i lëndës **Arti dramatik**, bazohet në rezultatet e parashikuara në programin mësimor të parashikuara të lëndës – **Arti dramatik për vitin e IV (katërtë)** të arsimit të mesëm – gjimnaz, që realizohet si lëndë zgjedhore sipas programit mësimor të përcaktuar.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema dhe njësi mësimore të caktuara që duhet të realizohen në 145 ditë mësimore, gjatë së cilës konsiderohet fondi i paraparë javor i orëve të përcaktuar në programin e rregullt, respektivisht për një lëndë mësimore me fond javor prej 2 orë, në programin e shkurtuar parashikohen 58 orë mësimore.

Mësuesi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar, drejtohet kah qëllimet/rezultatet e parashikuara, nocionet e përcaktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I TEMAVE DHE NJËSIVE MËSIMORE

FUSHA PROGRAMORE: ARTI DRAMATIK (58 orë) (Fushat dhe përmbajtjet)
TEATRI SI MEDIA - 2 orë
HISTORI E SHKURTËR E TEATRIT – 6 orë
Koncepti dhe origjina e teatrit
Miti – rituali- teatri
Teatri – art i arteve të shumëfishta
Kronologjia e teatrit
Teatri dhe mediat tjera

HISTORI E SHKURTËR E AKTRIMIT - 5 orë
Paraardhësit (shamanët, priftërinjtë, valltarët, karnevalistët)
Aktorët udhëtues
Aktorët në komedinë del'arte
Aktori i arsimuar në kohën moderne (Stanisllavski, Breht, Grotovski)
HISTORI E SHKURTËR E REGJISË – 3 orë
Paraardhësit („regjisorët" e mistereve mesjetare)
"Revolucioni regjisor" nga fillimi i shekullit të XX (Apia, Kreg, Mejerhold, Breht, Bruk)
HISTORI E SHKURTËR E LETRËS SË DRAMËS – 8 orë
Dramë, letër drame, dramaturgji
Drama si zhanr letrar dhe si lojë
Kategoritë e dramës. Veprimi dramatik, karakteri/personazhi dramatik, dialogu dramatik, situata dramatike
Teknika e dramës. Aristoteli. Fabula, personazhet, shprehja, arsyetimi (mendimi), performanca dhe kompozicioni muzikor
Llojet e dramave. Tragjedia. Komedia. Drama. Tragjikomedia. Melodrama. Farsa.
Llojet e formave të dramatike: me një akt, me tre akte, me pesë akte
Shumëllojshmëria e formave dramatike në shekullin e XX.
Sqarimi i termave: dramaturg dhe dramaturgji; dramaturgu dhe drama
HISTORI E SHKURTËR E KINESTETIKËS – 7 orë
Zanafilla
Funksionet themelore të kinestetikës
Rituali dhe lëvizja
Format e artit të vallëzimit – ritmi, lëvizja, ekspresioni
Gjuha moderne e trupit
Distinkcioni: vallëzim - lëvizje
Ritualet moderne të lëvizjes
BAZAT E PRODUKSIONIT TË TEATRIT DHE FILMIT – 4 orë
Nocioni produksion, producent dhe produkt. Menaxhmenti dhe marketingu në kulturë
Si të organizohet një shfaqje? Produksioni i një shfaqjeje teatrale. Nga hapat e vegjël tek produkti/prodhimi përfundimtar
Produksioni i filmit – veprimtari e shumë producentëve

USHTRIME PRAKTIKE TË REGJISË – 5 orë
Çfarë punon regjisori në teatër?
Regjisori dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tij
Regjia "E dukshme" dhe „E padukshme“
Regjisori dhe hapësira
USHTRIME PRAKTIKE TË LOJËS AKTRUESE – 4 orë
Imitimi dhe improvizimi
Dialog (gjestual dhe verbal) <i>Ushtrime me zhvillim dialogu</i>
Veprimi dhe konflikti. Si ndërtohet një personazh dramatik? (Karakteristikat e personazhit, temperamentit, detyra e personazhit)
Fytyra dhe maska
USHTRIME PRAKTIKE NË SHKRIMIN E NJË TEKSTI DRAMATIK - 4 orë
Qëllimi i tekstit dramatik, filmit dhe skenarit televiziv
Shkrimi fillon me një ide. Si kërkohen idetë, si formulohet ideja themelore. Zhvillimi i idesë themelore në sinopsis – përmbajtjen themelore
Shembujt themelor të shkrimit: ide, sinopsis, dialog, monolog, lojë me një akt
USHTRIME PRAKTIKE TË KINESTETIKËS - 4 orë
Ushtrime hyrëse. Përgatitja e trupit për punë – rruga për një trup aktiv dhe të ndjeshëm
Ushtrime ritmike
Improvizime
PËRGATITJA E SHFAQES TEATRALE – 3 orë
PROVAT PËRFUNDIMTARE DHE PERFORMIMI I SHFAQES TEATRALE – 3 orë

3. REKOMANDIMET DIDAKTIKE

Planifikimi i mësimit të **Artit dramatik** duhet të jetë në korrelacion me planin mësimor dhe programin mësimor të shkurtuar për këtë lëndë. Përmbajtja e programit të shkurtuar mësimor nga lënda Arti dramatik, është koncipuar në mënyrë që parashikon realizimin e saj në numër më të vogël të ditëve dhe orëve mësimore. E njëjta mundëson korrelacion dhe planifikim racional të mësimit me lëndët tjera mësimore: gjuhë angleze (apo gjuha e dytë e huaj) histori, gjeografi, arsim

figurativ, arsim muzikor etj. Për të arritur qëllimet e programit mësimor nga lënda Arti dramatik, është e domosdoshme të zbatohen teknika dhe metoda moderne aktive në punë siç janë: mbushja e kuadratis të shprazur, kënde, marrje në pyetje, një hyrje me shumë tekste, ditar me dy regjistrime etj. Teknikat e të mësuarit aktiv nxisin zbatimin efikas të aftësive dhe diturive të fituara në identifikim, përshkrim, sqarim, vërtetim, zhvillim të të menduarit kritik dhe kreativ gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

Mësimi në lëndën Arti dramatik është gjithpërfshirëse. Ajo do të bazohet mbi pjesëmarrjen aktive të nxënësit në parashtimin, udhëzimin (analizën) dhe zgjidhjen e problemeve dhe situatave për sa i përket përmbajtjeve nga programi mësimor. Programi do të realizohet në shkollë, në orë mësimore, në klasa dhe kabinetë të specializuar, në teatër, në skenë sipas orarit paraprak javor nga programi i shkurtuar mësimor.

Sipas vlerësimit të mësuesit, në drejtim të arritjes së qëllimeve të mësimin, nxënësi do të marrë detyra për punim të detyrave të shtëpisë, kryerja e mini – proekteve, ndjekja e Tv emisioneve të ndryshme, shfaqeve teatrale dhe filmike.

Mësuesi do të kryejë planifikim global, tematik dhe ditor të mësimdhënies, e cila do të përmbajë përshkrim të aktiviteteve të tij dhe të aktiviteteve të nxënësve. Përveç përshkrimit të aktiviteteve mësuesit dhe të nxënësve, përgatitja e mësuesit për orë do të nënkuptojë edhe komponentë motivacional shtesë për nxënësin nëpërmjet aktiviteteve të menduara.

Korrelacioni dhe racionalizimi në aspekt të planifikimit të mësimin në programin e shkurtuar mësimor të Artit dramatik, realizohet ndërmjet fushave të programit të saj. Roli kryesor i korrelacionit midis përmbajtjeve mësimore është të sigurojë një plotësim të njohurive që synojnë të realizohen në programin mësimor të shkurtuar. Programi i shkurtuar mësimor është e menduar si sistem i plotë i integruar, i ndërthurur në përmbajtje horizontale dhe vertikale, nocione dhe aktivitete nëpërmjet:

- lidhjes së njohurive të përfituara jashtëshkollore të nxënësit me atë që mësohet në shkollë;
- lidhjes së përmbajtjeve me njëra tjetrën , nocioneve dhe aktiviteteve (në korniza të lëndëve të ndryshme apo në korniza të vetë lëndës);
- lidhjes së asaj që tashmë është mësuar dhe asaj që mësohet tani.

Korrelacioni vertikal më së shpeshti është i pranishëm kur mësohet material i ri mësimor. Ajo duhet të bazohet në diçka që dihet tashmë (qoftë kjo në lidhje me përvojat e mëparshme shkollore apo jashtëshkollore).

Korrelacioni horizontal nënkupton vendosjen e lidhjeve midis përmbajtjeve dhe koncepteve të njëjta apo të lidhura nga fusha të ndryshme. Kjo mënyrë në të vërtetë është të mësuarit përmes krahasimit, kërkimit të ngjashmërive dhe dallimeve, lidhshmërisë, klasifikimit, plotësimit etj. Për realizimin e suksesshëm të programit të shkurtuar mësimor si një strukturë logjike, është e domosdoshme edhe korrelacioni vertikal edhe ai horizontal.

Si duhet të mësojnë nxënësit – Lidhur me programin e shkurtuar mësimor të Artit dramatik, nxënësit duhet të mësojnë:

Kuptimplotë, duke: lidhur atë që mësohet dhe atë që përjetohet në jetë si dhe atë që mësohet me atë që është mësuar më parë (nga lënda e njëjtë apo tjetër lëndë).

Problematike, duke: mbledhuar dhe analizuar në mënyrë të pavarur fakte dhe të dhëna, duke bërë pyetje relevante vetes dhe të tjerëve dhe duke zhvilluar një plan për të zgjidhur një problem të veçantë.

Divergjentisht, duke: hartuar dhe propozuar zgjidhje të reja dhe lidhjes së përmbytjeve dhe tërësive të reja.

Kritike, duke: selektuar rëndësinë e fakteve dhe të dhënave individuale dhe duke menduar argumente të përshtatshme.

Kooperativ, duke: bashkëpunuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë me mësuesin dhe shokët e klasës, diskutim dhe shkëmbim të mendimeve dhe respektim i mendimeve dhe argumenteve të shokëve të klasës.

Ndjekja dhe vlerësimi i të nxënit

Ndjekja dhe vlerësimi i nxënësve është pjesë e rolit profesional të mësuesit. Nga ai pritet që në kontinuitet të ndjekë dhe notojë: procesin e mësimin dhe të nxënit, por edhe rezultatet nga të mësuarit si dhe punën personale. Ndjekja e përparimit dhe vlerësimi i të arriturve të nxënësve është formativ dhe sumativ. Përveç mënyrave të zakonshme të ndjekjes dhe vlerësimit përmes kontrollimit me gojë dhe me shkrim, ka dhe shumë mënyra të tjera që mësuesi mund dhe duhet t'i përdorë për të vlerësuar objektivisht jo vetëm rezultatet, por edhe procesin e të nxënit.

Për sa i përket ndjekjes dhe vlerësimit të nxënësve, është e nevojshme të kombinohen mënyra të ndryshme të vlerësimit. Vetëm në këtë mënyrë mësuesi mund të shohë pikat e forta dhe të dobëta të nxënësit. Për çdo vlerësim i arritjeve të nxënësit, kërkohet që nxënësit t'i jepet informatë kthyesë që do ta ndihmojë atë t'i kuptojë gabimet e tij, të përmirësojë rezultatet e tij, por edhe të mësuarit e tij. Informata kthyesë gjithmonë duhet të jepet në kohën e duhur dhe duhet t'i referohet aktiviteteve dhe rezultateve të të nxënit që lidhen me nxënësin, jo me personalitetin e tij. Nxënësi duhet të inkurajohet vazhdimisht në mënyra të ndryshme për të menduar për cilësinë e punës së tij dhe për atë që duhet të bëjë për të përmirësuar të mësuarit e tij dhe për të përmirësuar arritjet e tij.

Në planifikimin e mësimdhënies, duhet të merret parasysh niveli i ndryshëm i peshës së përmbytjes brenda programit mësimor të shkurtuar, e cila rrjedh nga vendosja e qëllimeve që duhet të jetë baza e planifikimit të procesit mësimor. Të gjitha përmbytjet, nuk mund dhe nuk duhet t'i kushtohet vëmendje e njëjtë në mësimdhënie. Qasja ndaj tyre nga ana e mësuesit

duhet të jetë në atë mënyrë që nxënësit të fitojnë njohuri të përhershme që do të jenë të zbatueshme për ta në arsimimin e mëtejshëm dhe pas diplomimit. Në planifikim, gjithashtu, si pikënisje duhet të jetë vendosja e përmbajtjes mësimore, afati i nevojshëm kohor për realizimin e saj, si dhe niveli i arritjes së qëllimeve të përcaktuara.

Nxënësi mund të marrë nota për aktivitetet apo detyrat e mëposhtme të tij:

- punimi i një ese me temë nga teoria e arteve dramatike;
- aktrimi – rol i caktuar;
- regji;
- kinestetika - lëvizja;
- rolin që ka nxënësi në lojën përfundimtare.

Rekomandohet që fondi vjetor i ardhshëm për përdorimin e orëve për realizimin e programit të shkurtuar mësimor nga Arti dramatik: 58 orë në vit, respektivisht 2 orë në javë.

Shënim: fondi mesatar për përdorimin e orëve mësimore në fushat e programeve dhe nënprogrameve është vetëm një sugjerim. Secili mësues, sipas kushteve në të cilat realizon programin e shkurtuar mësimor dhe mundësive të nxënësve në mënyrë të pavarur sipas nevojave mund të përcaktojë fondin e orëve, fushave dhe nënfushave programore. Sigurisht që duhet të jenë 58 orë mësimore në 145 ditë.

Mjetet mësimore dhe ndihmëse:

Për të arritur qëllimet e mësimdhënies në lënden e artit dramatik, është e nevojshme të kemi një aplikim të menduar dhe planifikuar profesionalisht të mjeteve të ndryshme mësimore, kryesisht: tekste për analizë, materiale audio dhe video, tabelë, aparat televiziv, kompjuter me paketa të përshtatshme programore dhe akses në internet dhe projektor LCD.

Për realizimin e këtij programi të shkurtuar mësimor është e nevojshme të përdoren materialet e duhura mësimore. Rekomandohet të përgatiten dhe të përdoren koleksione të teksteve me ushtrime të përgatitura që do të përdoren për realizimin praktik të programit. Si dhe ndihmën e duhur, pra ndërhyrjen nga profesorët nga FAD.

4. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në përputhje me normativin për kuadër mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor për lëndën zgjedhore **Arti dramatik** për **vitin IV (e katërt)** të arsimit të mesëm- gjimnaz, e miratoi

Ministri i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska